



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 620/5 prot.

Datë 15/04/2022

V E N D I M

Nr. 349/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15/04/2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Infosoft Office*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF-00443-07-07-2021, me objekt “*Blerje Tонера*” e ndarë në 8 (tetë) lote”, me Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 259,114,090 (dyqind e pesëdhjetë nëntë milion e njëqind e katërbëdhjetë mijë e nëntëdhjetë) Lekë pa TVSH ose 2,113,147 € (dy milion e njëqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e dyzetë e shtatë) Euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë i datës 01.07.2021 është 122.62 Lekë, Loti 1 “*Blerje Tонера për Ministrinë e Mbrojtjes dhe institucionet e vartësisë*”, me Nr. REF-00446-07-07-2021 me fond limit 34.988.077 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.11.2021 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

Ankimues:

Operatori ekonomik “*Infosoft Office*” SHPK
Adresa: *Autostrada Tiranë-Durrës, km 8, Kashar, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor:

Agjencia e Blerjeve të Përqendruara

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 1, 1001, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 08.07.2021 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-00443-07-07-2021, me objekt “Blerje Tонера” e ndarë në 8 (tetë) lote”, me Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 259,114,090 Lekë pa TVSH ose 2,113,147 Euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë i datës 01.07.2021 është 122.62 Lekë, **Loti I** me Nr. REF-00446-07-07-2021 me objekt “Blerje

Tonera për Ministrinë e Mbrojtjes dhe institucionet e vartësisë” me fond limit të marrëveshjes kuadër 34.988.077 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.11.2021 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 12.11.2021 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 12.11.2021 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- Infosoft Office	12,290,715.04	I skualifikuar
- IT Gjergji Kompjuter	15,473,182.63	I skualifikuar
- Erisoni Company	20,820,590.00	I skualifikuar
- Interlogistic	32,290,715.04	I skualifikuar

II.4. Në datën 22.11.2021 operatori ekonomik *“Infosoft Office”* SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij, në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

“Operatori Ekonomik nuk përmbush pikën 7, seksioni 2.3 i Kapacitetit Teknik, të Kritereve të Veçanta për Kualifikim, pasi nuk ka paraqitur katalogë/ broshurë ku të shprehet qartë secili lloj i tonerit që oferton (sipas tonerave të përcaktuar në tabelën e përgjithshme, Shtojca 6)”.

II.5. Në datën 06.12.2021, autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e Njoftim-Anulimit në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 174, me datë 06.12.2021.

II.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se në datën 06.12.2021, operatori ekonomik ankimues *“Infosoft Office”* SHPK ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar arsyen e skualifikimit të tij.

II.7. Në përputhje me nenin 112 *“Veprimet paraprake”* të Ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesave, i publikoi ato në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 2459/2 prot., 09.12.2021, u publikuan arsyet e skualifikimit të operatori ekonomik ankimues *“Infosoft Office”* SHPK.

II.8. Me shkresën nr. 2112 prot., datë 17.12.2021 me objekt: *“Dërgim dokumentacioni”*, protokolluar me tonën me nr. 2459/3 prot., datë 21.12.2021, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimi i autoritetit kontraktor, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik *“Infosoft Office”* SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur mospranimi i ankesës.

II.9. Referuar nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, nuk është paraqitur asnjë argument nga operatorë ekonomikë të interesuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në lidhje me procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.10. Me vendimin Nr. 30/2022 datë 11.01.2022 Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

1. *Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr.REF-00443-07-07-2021, me objekt “Blerje Tonera” e ndarë në 8 (tetë) lote”, me Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 259,114,090 (dyqind e pesëdhjetë nëntë milion e njëqind e katërbëdhjetë mijë e nëntëdhjetë) Lekë pa TVSH ose 2,113,147 € (dy milion e njëqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e dyzetë e shtatë) Euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë i datës 01.07.2021 është 122.62 Lekë, Loti 1 “Blerje Tonera për Ministrinë e Mbrojtjes dhe institucionet e vartësisë”, me Nr. REF-00446-07-07-2021 me fond limit 34.988.077 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 11.12.2021 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.*
2. *Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, si dhe të korrigjojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.*
3. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK.*
5. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II. 11. Me shkresën nr. 385 prot, datë 04.03.2022, protokolluar me tonën nr. 2459/7 prot., datë 07.03.2022, autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 30/2022, datë 11.01.2022, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr.REF-00443-07-07-2021, me objekt “Blerje Tonera” e ndarë në 8 (tetë) lote”, me Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 259,114,090 (dyqind e pesëdhjetë e nëntë milionë e njëqind e katërbëdhjetë mijë e nëntëdhjetë) Lekë pa TVSH ose 2,113,147 € (dy milionë e njëqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e dyzetë e shtatë) Euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë i datës 01.07.2021 është 122.62 Lekë, Loti 1 “Blerje Tonera për Ministrinë e Mbrojtjes dhe institucionet e vartësisë”, me Nr. REF-00446-07-07-2021 me fond limit 34.988.077 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 11.12.2021 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, si edhe nga informacioni i autoritetit kontraktor depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Komisioni vëren se, autoriteti kontraktor ka kualifikuar operatorin ekonomik “Infosoft

Office” SHPK në përputhje me pikën 2 të dispozitivit të vendimit Nr. 30/2022 datë 11.01.2022.

II.12. Me vendimin nr. 234/2022 datë 09.03.2022 Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr.REF-00443-07-07-2021, me objekt “Blerje Tонера” e ndarë në 8 (tetë) lote”, me Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 259,114,090 (dyqind e pesëdhjetë e nëntë milionë e njëqind e katërbëdhjetë mijë e nëntëdhjetë) Lekë pa TVSH ose 2,113,147 € (dy milionë e njëqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e dyzetë e shtatë) Euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë i datës 01.07.2021 është 122.62 Lekë, Loti 1 “Blerje Tонера për Ministrinë e Mbrojtjes dhe institucionet e vartësisë”, me Nr. REF-00446-07-07-2021 me fond limit 34.988.077 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 11.12.2021 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara..

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.13. Në datën 02.03.2022 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi riklasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

- Infosoft Office	12,290,715.04	I skualifikuar
- IT Gjergji Kompjuter	15,473,182.63	I skualifikuar
- Erisoni Company	20,820,590.00	I skualifikuar
- Interlogistic	32,290,715.04	I skualifikuar

II.14. Në datën 02.03.2022 operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

Pas shqyrtimit të informacionit mbi ofertën anomalisht të ulët të përcjellë nga ofertuesi “Infosoft office” ShPK, në mënyrë elektronike dhe në mënyrë shkresore protokolluar me tonën nr. 75/1 prot., datë 20.01.2022, dhe nr. 80/1 prot., datë 20.01.2022 ka rezultuar se, shpjegimet e paraqitura për analizën e kostot dhe çmimit të ofertuar, duke llogaritur mbi çmimin e blerjes shpenzimet dhe fitimin e përcaktuar nga vet operatori ekonomik, nuk janë të sakta. Konkretisht, nuk është paraqitur informacion i saktë për anën ekonomike, në përputhje me parashikimet e nenit 93 pika 2 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”. Gjithashtu, nga dokumentacioni i paraqitur me shkresën për sqarim me nr.75/3 prot., datë 31.01.2022, rezulton se, oferta e operatorit ekonomik “Infosoft Office” ShPK refuzohet, pasi, edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur, nuk arriti që të bindë AK se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj, duke marrë në konsideratë elementet e përmendura në pikën 2 të këtij neni.

II.15. Në datën 16.03.2022 autoriteti kontraktor, ka njoftuar operatorin ekonomik ankimues, se nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve, si dhe e ka publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 36, me datë 23.03.2022.

II.16. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 24.03.2022 operatori ekonomik “*Infosoft Office*” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më datë 25.03.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me pretendimet si më poshtë:

Lidhur me arsyen e skualifikimit sqarojmë si më poshtë:

Në nenin 93 pika 2 (të cilës i referohet AK) e vetmja pikë, që kërkon sqarime lidhur me anën ekonomike është pika a):

“1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se ofertat për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe Brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit.”.

Referuar kësaj pike kemi paraqitur oferta të marra nga furnitorët tanë enkas për këtë tender, fatura të blerjes së produkteve, fletë zhdoganimi të produkteve, si edhe analizën e detajuar të kostos për çdo artikull. Po të analizohen çmimet e paraqitura në to, shihet lehtësisht, që produktet janë blerë apo do të blihen me çmime me të ulëta se ato të paraqitura në tender, duke vërtetuar plotësisht, që kompania jonë ka të gjitha mundësitë reale për t'i siguruar produktet e prokuruar me çmime më të ulëta sesa ato të ofertuara.

Detyrimi jonë, në bazë të LPP, është të sjellim prova dhe argumente, që të sigurojmë AK, se OE ka mundësi reale të sigurojë furnizimin e artikujve me çmimet e ofertuara. Në argumentimin tonë lidhur me pikën 2. a) të nenit 93 të LPP, janë dhënë në mënyrën më të detajuar të mundshme, të gjitha argumentet dhe provat për çdo artikull të ofertës sonë, Të gjitha provat e dhëna të çojnë vetëm në përfundimin se oferta e dhënë nga ana jonë, është tepër e përgjegjshme dhe e bazuar në mënyrë shumë korrekte në mundësitë tona, aftësitë tona dhe burimet tona, për të siguruar çmimet më të mira në treg, duke përmbushur të gjitha kërkesat e AK-së.

Megjithatë, ne kemi dhënë një informacion tepër të detajuar, mbi të gjitha planifikimet që ka bërë kompania, për realizimin e këtij tenderi.

Në tërësinë e saj, kërkesa për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët për këtë pikë të nenit 93 pika 2, konsiston në paraqitjen e shpjegimeve mbi ndërtimin e ofertës ekonomike shoqëruar me dokumente provuese, që vërteton mundësinë e OE për të siguruar çmime nën çmimet e kuotuar dhe shpjegimi e dokumentacioni provues i paraqitur prej nesh e vërteton këtë.

Sikurse kemi shprehur edhe ne argumentimin tonë, ky tender ka pasur një volum shumë të madh dhe gjithashtu një kompleksitet të madh. Megjithëse kanë qenë 8 lote, këto duhen parë si një e tërë, pasi lotet lidhen pazgjidhshinërisht me njëri tjetrin, për faktin se artikujt përsëriten në mënyrë të rregullt nëpër lote, me sasi të ndryshme, por me detyrimin që çmimi të jetë i njëjtë në të gjitha lotet. Për arsye të sasive të mëdha, disa herë, mund të ndodhë që furnitorët të na kenë dhënë sipas sasive që disponojnë çmime të ndryshme për të njëjtin artikull. Një çmim për sasinë që e kanë pasur në magazinë dhe një çmim për sasinë e pritshme nga prodhimi i tyre ose edhe nga furnitorët e tyre. Sidoqoftë, kompania jonë, me përgjegjshmëri, ka bërë kalkulime të sakta, për t'ju përmbajtur detyrimin ligjor që të kuotojë megjithatë me të njëjtin çmim për të njëjtin artikull, në të gjitha lotet.

Vlen të theksojmë që “Infosoft Office” sh.p.k., është kompania më e madhe në treg, në fushën e tregtimit të tonerave. Është fituese e një numri të lartë të procedurave me këtë objekt, në të gjithë administratën shtetërore, gjatë gjithë periudhës 25 vjeçare të veprimtarisë së kompanisë sonë, ku ndër këto një numër të konsiderueshëm e zënë edhe procedurat e realizuara nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara. Gjatë gjithë kësaj periudhe nuk ka ASNJË rast, që kompania jonë të mos i përmbahet detyrimeve kontraktuale, përkundrazi, ka realizuar me sukses të plotë, çdo detyrim kontraktual.

Oferta jonë nuk mund të jetë kurrsesi e papërgjegjshme apo e papranueshme, edhe pasi janë dhënë të gjitha sqarimet e shoqëruara me prova, vetëm sepse KVO e AK në mënyrë subjektive shprehet se nuk bindet nga sqarimet e dhëna, sepse sipas KVO këto kanë pasaktësi. Pra, në thelb, asnjë nga çështjet e konsideruara si shkaqe për mospranim të argumentimit tonë nga KVO e AK nuk qëndrojnë pasi rezultojnë se:

KVO ka këmbëngulur që ndërtimi i strukturës së shpenzimeve duhet të bëhet me një metodë të ndryshme nga ajo të cilën ne kemi aplikuar dhe e konsideron këtë pasaktësi. Për këtë pikë duhet sqaruar, se kuadri rregullator nuk përcakton detaje të tilla, pra nuk përcaktohen formula specifike që duhen përdorur në raste të tilla. Në këto rrethana, në mënyrë të saktë, të drejtë e reale, ne kemi aplikuar metodën që ne realisht kemi përdorur në ndërtimin e ofertës tonë. Në fund të fundit kjo është një zgjedhje strategjike e të bërit biznes dhe çdo imponim për të vepruar ndryshe do të ishte ndërhyrje e pajustificuar e AK në zgjidhjet operacionale të biznesit, e stilit të “ekonomive të planifikuara”. Sidoqoftë, vlen të theksojmë sërish, se në çfarëdo skenari përlllogaritje, rezultati është po i njëjti në thelb: Ne provojmë se çmimet e blerjes së marra prej nesh nga furnitorët justifikojnë plotësisht çmimet e ofruara prej nesh, pra zbatimi me sukses i kontratës është i garantuar.

Përveç analizës së detajuar e të provuar të çmimit të dhënë nga ana jonë, ka edhe një arsye tjetër për çmimet e ofruara nga ana jonë, që lidhet me vetë dinamikën e procedurës nga planifikimi në momentin e ofertimit. Konkretisht kërkesa e Agjencisë në fazën e përlllogaritjes së fondit, ka qenë vetëm për tonera origjinale të prodhuesve të pajisjeve (me këtë produkt janë furnizuar institucionet çdo vit), ndërkohë që me të gjitha ndryshimet e bëra në DST, kërkesa ka ndryshuar në “tonera origjinale ose ekuivalent”. Ky është një ndryshim thelbësor, që çon në kuotimin me çmime më të ulëta për shkak të zgjerimit të gamës së produkteve që mund të ofrohen. Pra, fondi është llogaritur për vetëm një kategori produkti, ndërsa

ndryshimet në DST kanë krijuar mundësinë për të ofertuar edhe me produkte të tjera ekuivalente që sigurisht vijnë me kosto më të ulët në blerje.

Vëmë në dukje gjithashtu edhe rëndësinë që ka kjo procedurë për AK përfituese të kësaj procedure. Gjatë gjithë vitit 2021, AK nuk janë furnizuar me tonera. Duke çuar drejt anulimit këtë procedurë, dëmi që i shkaktohet AK, është shumë i madh, pasi rrezikohet funksionimi i tyre edhe për një periudhë të gjatë kohore. Pra interesi publik vihet shumë në rrezik me këtë anulim procedure.

Për të përforcuar shpjegimet e dhëna më sipër, na lejoni të sjellim në vëmendjen tuaj edhe interpretimin e bërë nga SIGMA në Udhëzimin nr. 35 të vitit 2016 “Ofertat anomalisht të ulëta”: “Direktiva shprehet se autoritetet kontraktore mund të refuzojnë vetëm një ofertë, kur provat e paraqitura nuk argumentojnë në mënyrë të kënaqshme nivelin e ulët të çmimit ose të kostos së propozuar, duke marrë parasysh shpjegimet e ofruara nga operatori ekonomik. Autoriteti kontraktor ka të drejtë vetëm të refuzojë ofertën kua ai ka vendosur, pas hetimeve që oferta është me të vërtetë anomalisht e ulët. Nëse shpjegimet e dorëzuara nga ana e operatorit ekonomik, të cilat autoriteti kontraktor I ka analizuar në konsultim me këtë operator ekonomik, tregojnë se çmimi (kosto) është e vërtetë, atëherë oferta nuk mund të konsiderohet si ofertë anomalisht e ulët dhe nuk mund të hidhet poshtë.”.

Pra në konkluzion rezulton se shpjegimet e dhëna prej nesh së bashku me provat e shumta shoqëruese, tregojnë se çmimet e ofertuara janë reale, të mundshme, nuk paraqesin asnjë rrezik për moszbatim të kontratës në kohë dhe cilësi, nuk janë të lidhura me avantazhe të ndihmës shtetërore dhe as nuk ekziston asnjë rrezik që AK përfitues të përballet me kërkesa për rritje të kostove gjatë zbatimit të kontratës, pasi këto çmime janë fikse dhe të pandryshueshme.

Çdo paqartësi e KVO së AK e lidhur me “pasaktësi” eventuale, në rastin më ekstrem thjesht krijon detyrimin për të sqaruar dhe saktësuar këto çështje (ç’ka është bërë me sqarimin tonë shtesë), por nuk mund të jetë shkak për refuzimin e ofertës sit ë papranueshme, për sa kohë nuk vihet në dyshim në mënyrë objektive dhe specifike mundësia reale për të zbatuar kontratën me çmimet e ofertuara.

Lidhur me dokumentacionin e paraqitur, sqarojmë se jemi të detyruar të paraqesim të gjithë dokumentacionin e njëjtë, në të gjitha lotet, për arsyen se të gjitha dokumentet e paraqitura shërbejnë njëkohësisht dhe janë të nevojshme për të gjitha lotet. Kjo për arsyen se siç kemi shpjeguar ka shumë përsëritje artikujsh dhe ofertat e marra nga furnitorët etj., natyrisht i referohen artikujve në total.

II.17. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 620/2 prot., datë 25.03.2022, u publikuan kriteret e skualifikimit, të cilat operatori ekonomik ankimues “InfoSoft Office” SHPK pretendon se i plotëson.

II.18. Me shkresën nr. 571 prot, datë 05.04.2022 me objekt: “Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit me objekt: Loti I “Blerje tonera për Ministrinë e Mbrojtjes dhe institucionet e varësisë”, protokolluar me tonën me nr. 620/3 prot, datë 08.04.2022, dhe me shkresën datë 08.04.2022, me objekt: “Argumente shtesë lidhur me përgjigjen e ABP për tenderin me objekt: “Blerje tonera” e ndarë në 8 (tetë) LOTE, konkretisht Loti I “Blerje tonera për Ministrinë e Mbrojtjes dhe institucionet e varësisë”, me fond të marrëveshjes kuadër 34.998.077 lekë (pa TVSH) me nr. REF-00446-07-07-2021)” protokolluar me tonën me nr. 620/4 prot, datë 11.04.2022, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni dhe vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur mospranimi i ankesës me argumentet si më poshtë:

Në zbatim të ligjit 162/2020 dhe të VKM-së 285/2021, Komisioni i Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave, në mbështetje të Vendimit të KPP Nr. 25/2022, datë 11.01.2022, procedoi me rivlerësimin e ofertës së Operatorit Ekonomik “Infosoft Office” SHPK, me nipt J62426002Q duke e kualifikuar këtë ofertë.

Në zbatim të LPP-së dhe RPP-së oferta e OE “Infosoft Office” SHPK, rezulton anomalisht e ulët. Përpara se të vijonte me mbylljen e fazës KVO i dërgoi kërkesë për argument për ofertën anomalisht të ulët operatorit ekonomik “Infosoft Office” ShPK, me shkresë nr 75 prot., date 18.01.2022 dhe 75/2, datë 27.01.2022.

Nga ofertuesi “Infosoft office” ShPK, në mënyrë elektronike dhe në mënyrë shkresore ka paraqitur pranë Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara shkresat protokolluar me tonën nr. 75/1 prot., datë 20.01.2022 dhe 75/23.

Për ofertuesin “Infosoft Office” ShPK, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, ka bërë skualifikimin e ofertës së tij me arsyen si vijon: “Pas shqyrtimit të informacionit mbi ofertën anomalisht të ulët të përcjellë nga ofertuesi “Infosoft office” ShPK, në mënyrë elektronike dhe në mënyrë shkresore protokolluar me tonën nr. 75/1 prot., datë 20.01.2022, dhe nr. 80/1 prot., datë 20.01.2022 ka rezultuar se, shpjegimet e paraqitura për analizën e kostot dhe çmimit të ofertuar, duke llogaritur mbi çmimin e blerjes shpenzimet dhe fitimin e përcaktuar nga vet operatori ekonomik, nuk janë të sakta. Konkretisht, nuk është paraqitur informacion i saktë për anën ekonomike, në përputhje me parashikimet e nenit 93 pika 2 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”. Gjithashtu, nga dokumentacioni i paraqitur me shkresën për sqarim me nr.75/3 prot., datë 31.01.2022, rezulton se, oferta e operatorit ekonomik “Infosoft Office” ShPK refuzohet, pasi, edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur, nuk arriti që të bindë AK se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj, duke marrë në konsideratë elementet e përmendura në pikën 2 të këtij neni.”.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, verifikoi dokumentet e tenderit, procesverbalin nr.4, “Për rivlerësimin e ofertave”, si dhe pretendimet e parashtruara mbi ankesë nga operatori ekonomik ankimues “Infosoft Office” ShPK, dhe konstatoi:

Në nenin 93, të ligjit 162/2020, parashikohet: “1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon

operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj, duke marrë në konsideratë elementet e përmendura në pikën 2 të këtij neni.

Autoritetet ose entet kontraktore e refuzojnë ofertën kur konstatojnë se oferta është anomalisht e ulët, sepse nuk pajtohet me detyrimet e zbatueshme nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës e të akteve të tjera.”

Bazuar në bazën ligjore të sipërcituar KSHA shqyrtoi argumentimet e shoqërisë “Infosoft Office” SHPK të paraqitura në shkresën protokolluar me tonën nr. 75/1 prot., datë 20.01.2022.

Për procedurën e prokurimit me objekt Lotin I “Blerje Tonera për Ministrinë e Mbrojtjes dhe institucionet e vartësisë”, ky ofertues përveç shpjegimeve të tjera të parashikuara në nenin 93, të LPP- së ka paraqitur edhe analizën e kostos së produkteve të ofertuara.

Në tabelën analizuese lidhur me artikuj objekt prokurimi janë paraqitur të dhënat si më poshtë:

NR	Emërtimi	Lloji i pajisjes	Kodi	Ngjyrat	Njësinë	Sasia	Çmimi ofertuar/njësi (pa TVSH)	Çmimi i blerjes/njësi (pa TVSH)
----	----------	------------------	------	---------	---------	-------	--------------------------------	---------------------------------

Këto të dhëna janë cituar zë për zë për të gjithë artikujt.

Nga verifikimi i shumatores së të gjithë zërave sipas çmimit të ofertuar rezulton se vlera totale e ofertuar është 12,728,440, lekë pa TVSH dhe vlera totale sipas çmimit të blerjes për këto artikuj është 9,235,554 lekë pa TVSH.

Diferenca totale midis vlerës së ofertuar nga ky OE dhe kostos së blerjes së këtyre artikujve rezulton 3,492,886 lekë pa TVSH.

Ofertuesi Infosoft Office SHPK, nëpërmjet një table të dytë ka sqaruar:

Shpenzime të përgjithshme	
Paga punonjësish	10%
Kosto transporti nga Importi	10%
Kosto transporti për lëvrimin	1.80%
<u>Kosto të tjera (kosto dogane, qira, energji elektrike, noterizime etj)</u>	2%
Fitimi	18%

Vlen të theksohet se nuk është specifikuar se mbi cilën vlerë janë llogaritur këto përqindje.

Në rastin se operatori ekonomik pretendon se këto janë përqindjet lidhur me peshën që zë secili zë i shpenzimeve të përgjithshme në fitimin bruto, atëherë vërejmë se totali i tyre rezulton të jetë 41.8% dhe jo 100% ashtu si duhet të ishte.

Gjithsesi, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave provoi të shpërndaj vlerën e përqindjeve të deklaruar nga ofertuesi mbi fitimin bruto, pra mbi diferencën midis vlerës së ofertuar dhe të kostos së blerjes, në vlera reale.

Kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

*Paga punonjësish: $3,492,886 * 10\% = 349,288.6$ lekë;*

*Kosto transporti nga importi: $3,492,886 * 10\% = 349,288.6$ lekë Kosto transporti për lëvrimin: $3,492,886 * 1.8\% = 62,871.9$ lekë Kosto të tjera: $3,492,886 * 2\% = 69,857$ lekë*

Në këtë rast, pas shpenzimeve të llogaritura më sipër, për fitimin neto rezulton vlera 831,306.87 lekë dhe duke e llogaritur me përqindje, fitimi neto rezulton të jetë 76% e fitimit bruto dhe jo 18% ashtu si deklaroi ofertuesi në tabelën e paraqitur prej tij.

Nëse do ta masim fitimin neto mbi vlerën totale të ofertuar për këtë Lot, atëherë vlera 5,299,690 lekë, rezulton të jetë 20.9% mbi vlerën e ofertuar.

Nëse i referohemi shkresës sqaruese të dërguar nga OE "Infosoft Office" SHPK pranë ABP-së, ku ky ofertues pretendon në ndërtimin e tabelës së shpenzimeve logjika e përdorur është si më poshtë:

A	B	C	D	E	F
Vlera e ofertuar pa TVSH	Vlera e blerjes së mallit pa TVSH	Fitimi bruto (A-B)	Vlera e shpenzimeve e llogaritur nga fitimi Bruto	Fitimi neto në vlerë (C-D)	Fitimi neto në përqindje (F-A)
12,728,440	9,235,554	3,492,886	831,307	2,661,579	20.9%

Pra sipas shkresës sqaruese ofertuesi pranon se fitimi neto në përqindje për këtë procedurë prokurimi është 20.9% duke rënë ndesh me argumentet e dorëzuara në fillim prej tij.

Gjithashtu Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, verifikoi dokumentacionin bashkëngjitur analizës së kostove, dhe konstatoi mospërputhje midis disa prej çmimeve të blerjes së disa prej artikujve në faturat e blerjes me çmimet e blerjes së deklaruar nga ofertuesi për këto artikuj në tabelën analizuese të kostos.

Duke marrë në konsideratë gjithë elementet e përmendura më sipër vihet re mospërputhje si në tabelat analizuese të kostos ashtu edhe në dokumentacionin bashkëlidhur.

Në pikën 4, të nenit 82, të VKM-së 285/2021 parashikohet: “... Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.”.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, gjykon se ofertuesi “Infosoft Office” SHPK, nuk ka argumentuar në mënyrë korrekte analizën e kostos dhe çmimit të ofertuar duke llogaritur mbi çmimin e blerjes shpenzimet dhe fitimin e përcaktuar nga vet operatori ekonomik, e si rrjedhim nuk është paraqitur informacion i saktë për anën ekonomike.

Për sa sipër, organi qendror blerës ju sjell në vëmendje se është përgjegjësi e operatorit ekonomik ofertues, të argumentojë dhe dokumentojë me prova shkresore sqarimet për ofertën e tij.

Për sa më sipër, pretendimi i ankimuesit “Infosoft Office” ShPK nuk qëndron.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi me arsyetimin se: “Lidhur me arsyen e skualifikimit sqarojmë si më poshtë:

Në nenin 93 pika 2 (të cilës i referohet AK) e vetmja pikë, që kërkon sqarime lidhur me anën ekonomike është pika a):

“1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se ofertat për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe Brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit.”.

Referuar kësaj pike kemi paraqitur oferta të marra nga furnitorët tanë enkas për këtë tender, fatura të blerjes së produkteve, fletë zhdoganimi të produkteve, si edhe analizën e detajuar të kostos për çdo artikull. Po të analizohen çmimet e paraqitura në to, shihet lehtësisht, që

produktet janë blerë apo do të blihen me çmime me të ulëta se ato të paraqitura në tender, duke vërtetuar plotësisht, që kompania jonë ka të gjitha mundësitë reale për t'i siguruar produktet e prokuruar me çmime më të ulëta sesa ato të ofertuar.

Detyrimi jonë, në bazë të LPP, është të sjellim prova dhe argumente, që të sigurojmë AK, se OE ka mundësi reale të sigurojë furnizimin e artikujve me çmimet e ofertuar. Në argumentimin tonë lidhur me pikën 2. a) të nenit 93 të LPP, janë dhënë në mënyrën më të detajuar të mundshme, të gjitha argumentet dhe provat për çdo artikull të ofertës sonë, Të gjitha provat e dhëna të çojnë vetëm në përfundimin se oferta e dhënë nga ana jonë, është tepër e përgjegjshme dhe e bazuar në mënyrë shumë korrekte në mundësitë tona, aftësitë tona dhe burimet tona, për të siguruar çmimet më të mira në treg, duke përbushur të gjitha kërkesat e AK-së.

Megjithatë, ne kemi dhënë një informacion tepër të detajuar, mbi të gjitha planifikimet që ka bërë kompania, për realizimin e këtij tenderi.

Në tërësinë e saj, kërkesa për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët për këtë pikë të nenit 93 pika 2, konsiston në paraqitjen e shpjegimeve mbi ndërtimin e ofertës ekonomike shoqëruar me dokumente provuese, që vërteton mundësinë e OE për të siguruar çmime nën çmimet e kuotuar dhe shpjegimi e dokumentacioni provues i paraqitur prej nesh e vërteton këtë.

Sikurse kemi shprehur edhe ne argumentimin tonë, ky tender ka pasur një volum shumë të madh dhe gjithashtu një kompleksitet të madh. Megjithëse kanë qenë 8 lote, këto duhen parë si një e tërë, pasi lotet lidhen pazgjidhshinërisht me njëri tjetrin, për faktin se artikujt përsëriten në mënyrë të rregullt nëpër lote, me sasi të ndryshme, por me detyrimin që çmimi të jetë i njëjtë në të gjitha lotet. Për arsye të sasive të mëdha, disa herë, mund të ndodhë që furnitorët të na kenë dhënë sipas sasive që disponojnë çmime të ndryshme për të njëjtin artikull. Një çmim për sasinë që e kanë pasur në magazinë dhe një çmim për sasinë e pritshme nga prodhimi i tyre ose edhe nga furnitorë të tyre. Sidoqoftë, kompania jonë, me përgjegjshmëri, ka bërë kalkulime të sakta, për t'ju përmbajtur detyrimin ligjor që të kuotojë megjithatë me të njëjtin çmim për të njëjtin artikull, në të gjitha lotet.

Vlen të theksojmë që "Infosoft Office" sh.p.k., është kompania më e madhe në treg, në fushën e tregtimit të tonerave. Është fituese e një numri të lartë të procedurave me këtë objekt, në të gjithë administratën shtetërore, gjatë gjithë periudhës 25 vjeçare të veprimtarisë së kompanisë sonë, ku ndër këto një numër të konsiderueshëm e zënë edhe procedurat e realizuara nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara. Gjatë gjithë kësaj periudhe nuk ka ASNJË rast, që kompania jonë të mos i përmbahet detyrimeve kontraktuale, përkundrazi, ka realizuar me sukses të plotë, çdo detyrim kontraktual.

Oferta jonë nuk mund të jetë kurrsesi e papërgjegjshme apo e papranueshme, edhe pasi janë dhënë të gjitha sqarimet e shoqëruara me prova, vetëm sepse KVO e AK në mënyrë subjektive shprehet se nuk bindet nga sqarimet e dhëna, sepse sipas KVO këto kanë pasaktësi. Pra, në thelb, asnjë nga çështjet e konsideruara si shkaqe për mospranim të argumentimit tonë nga KVO e AK nuk qëndrojnë pasi rezultojnë se:

KVO ka këmbëngulur që ndërtimi i strukturës së shpenzimeve duhet të bëhet me një metodë të ndryshme nga ajo të cilën ne kemi aplikuar dhe e konsideron këtë pasaktësi. Për këtë pikë duhet sqaruar, se kuadri rregullator nuk përcakton detaje të tilla, pra nuk përcaktohen formula specifike që duhen përdorur në raste të tilla. Në këto rrethana, në mënyrë të saktë, të drejtë e reale, ne kemi aplikuar metodën që ne realisht kemi përdorur në ndërtimin e ofertës tonë. Në fund të fundit kjo është një zgjedhje strategjike e të bërit biznes dhe çdo imponim për të vepruar ndryshe do të ishte ndërhyrje e pajustificuar e AK në zgjidhjet operationale të biznesit, e stilit të “ekonomive të planifikuara”. Sidoqoftë, vlen të theksojmë sërish, se në çfarëdo skenari përlllogaritje, rezultati është po i njëjti në thelb: Ne provojmë se çmimet e blerjes së marra prej nesh nga furnitorët justifikojnë plotësisht çmimet e ofruara prej nesh, pra zbatimi me sukses i kontratës është i garantuar.

Përveç analizës së detajuar e të provuar të çmimit të dhënë nga ana jonë, ka edhe një arsye tjetër për çmimet e ofruara nga ana jonë, që lidhet me vetë dinamikën e procedurës nga planifikimi në momentin e ofertimit. Konkretisht kërkesa e Agjencisë në fazën e përlllogaritjes së fondit, ka qenë vetëm për tonera origjinale të prodhuesve të pajisjeve (me këtë produkt janë furnizuar institucionet çdo vit), ndërkohë që me të gjitha ndryshimet e bëra në DST, kërkesa ka ndryshuar në “tonera origjinale ose ekuivalent”. Ky është një ndryshim thelbësor, që çon në kuotimin me çmime më të ulëta për shkak të zgjerimit të gamës së produkteve që mund të ofertojnë. Pra, fondi është llogaritur për vetëm një kategori produkti, ndërsa ndryshimet në DST kanë krijuar mundësinë për të ofertuar edhe me produkte të tjera ekuivalente që sigurisht vijnë me kosto më të ulët në blerje.

Vëmë në dukje gjithashtu edhe rëndësinë që ka kjo procedurë për AK përfituese të kësaj procedure. Gjatë gjithë vitit 2021, AK nuk janë furnizuar me tonera. Duke çuar drejt anulimit këtë procedurë, dëmi që i shkaktohet AK, është shumë i madh, pasi rrezikohet funksionimi i tyre edhe për një periudhë të gjatë kohore. Pra interesi publik vihet shumë në rrezik me këtë anulim procedure.

Për të përforcuar shpjegimet e dhëna më sipër, na lejoni të sjellim në vëmendjen tuaj edhe interpretimin e bërë nga SIGMA në Udhëzimin nr. 35 të vitit 2016 “Ofertat anomalisht të ulëta”: “Direktiva shprehet se autoritetet kontraktore mund të refuzojnë vetëm një ofertë, kur provat e paraqitura nuk argumentojnë në mënyrë të kënaqshme nivelin e ulët të çmimit ose të koston së propozuar, duke marrë parasysh shpjegimet e ofruara nga operatori ekonomik. Autoriteti kontraktor ka të drejtë vetëm të refuzojë ofertën kua ai ka vendosur, pas hetimeve që oferta është me të vërtetë anomalisht e ulët. Nëse shpjegimet e dorëzuara nga ana e operatorit ekonomik, të cilat autoriteti konteaktor I ka analizuar në konsultim me këtë operator ekonomik, tregojnë se çmimi (kosto) është e vërtetë, atëherë oferta nuk mund të konsiderohet si ofertë anomalisht e ulët dhe nuk mund të hidhet poshtë.”.

Pra në konkluzion rezulton se shpjegimet e dhëna prej nesh së bashku me provat e shumta shoqëruese, tregojnë se çmimet e ofertuara janë reale, të mundshme, nuk paraqesin asnjë rrezik për moszbatim të kontratës në kohë dhe cilësi, nuk janë të lidhura me avantazhe të ndihmës shtetërore dhe as nuk ekziston asnjë rrezik që AK përfitues të përballet me kërkesa për rritje të kostove gjatë zbatimit të kontratës, pasi këto çmime janë fikse dhe të pandryshueshme.

Çdo paqartësi e KVO së AK e lidhur me “pasaktësi” eventuale, në rastin më ekstrem thjesht krijon detyrimin për të sqaruar dhe saktësuar këto çështje (ç’ka është bërë me sqarimin tonë shtesë), por nuk mund të jetë shkak për refuzimin e ofertës sit ë papranueshme, për sa kohë nuk vihet në dyshim në mënyrë objektive dhe specifike mundësia reale për të zbatuar kontratën me çmimet e ofertuara.

Lidhur me dokumentacionin e paraqitur, sqarojmë se jemi të detyruar të paraqesim të gjithë dokumentacionin e njëjtë, në të gjitha lotet, për arsyen se të gjitha dokumentet e paraqitura shërbejnë njëkohësisht dhe janë të nevojshme për të gjitha lotet. Kjo për arsyen se siç kemi shpjeguar ka shumë përsëritje artikujsh dhe ofertat e marra nga furnitorët etj., natyrisht i referohen artikujve në total.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dorëzuar pranë KPP-së me shkresën nr. 571 prot, datë 05.04.2022 me objekt: “Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit me objekt: Loti I “Blerje tonera për Ministrinë e Mbrojtjes dhe institucionet e varësisë”, protokolluar me tonën me nr. 620/3 prot, datë 08.04.2022, dhe me shkresën datë 08.04.2022, me objekt: “Argumente shtesë lidhur me përgjigjen e ABP për tenderin me objekt; “Blerje tonera” e ndarë në 8 (tetë) LOTE, konkretisht Loti 1 “Blerje tonera për Ministrinë e Mbrojtjes dhe institucionet e varësisë”, me fond të marrëveshjes kuadër 34.998.077 lekë (pa TVSH) me nr. REF-00446-07-07-2021)” protokolluar me tonën me nr. 620/4 prot, datë 11.04.2022, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimes, rezulton se KVO gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave në aplikim të formulës mbi ofertën anomalisht të ulët ka konstatuar, se oferta e shoqërisë “Infosoft Office” SHPK është në kushtet e ofertës anomalisht të ulët. Në këto kushte KVO me shkresat nr. 75 prot, datë 17.01.2022 dhe nr. 75/2 prot, datë 27.02.2022, i është drejtuar operatorit ekonomik me kërkesë për sqarim/argumentim oferte anomalisht të ulët sipas nenit 93 të LPP-së.

III.1.2. Në përgjigje të kërkesës së KVO më datë 20.01.2022 operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK me qëllim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët ka paraqitur në mënyrë shkresore dokumentacionin si më poshtë:

- Shkresë datë 19.01.2022 Sqarim për ofertën anomalisht të ulët
- Shkresë datë 28.01.2022 me lëndë : Sqarim për ofertë anomalisht të ulët
- Analizë kosto loti 1 për të gjithë artikujt objekt prokurimi (emërtimi, lloji i pajisjes, kodi, ngjyrat , njësia, sasia, çmimi i ofertuar/njësi pa TVSh, çmimi i blerjes /njësi pa TVSh, me sqarimin si më poshtë:

Sqarojmë se për një pjesë të tonerave Lexmark dhe Xerox origjinale oferta është marrë nga distributori rajonal përkatësisht infolex dhe xerox ndërsa furnizimi me produkte do të realizohet përmes distributorit vendas ITD ShPK.

Shpenzime të përgjithshme	
Paga punonjësish	10 %

<i>Kosto transporti nga importi</i>	<i>10 %</i>
<i>Kosto transporti për lëvrimin</i>	<i>1.8 %</i>
<i>Kosto të tjera (dogana, qira, energji elektrike, noterizime etj.)</i>	<i>2 %</i>
<i>Fitimi</i>	<i>20.9 %</i>

- *Analizë Kosto e Përgjithshme për të gjitha lotet.*
- *Fatura Tatimore Shitje*
- *Deklarata Doganore*
- *Ofertë nga Albamedia*
- *Ofertë nga i.Aicon Zhuhai Aicon Image co ltd*
- *Ofertë nga Lexmark*
- *Ofertë nga Union Technology International*
- *Vërtetime Realizimi Kontratash*
- *Deklaratë Zhuhai Aicon Image co ltd*
- *Deklaratë Union Technology International*
- *Certifikata ISO*
- *Vërtetim numër punonjësish*

III.1.3. Në nenin 93 pika 1 dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj [....]”

III.1.4. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur;
- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.
- Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPPsë.
- Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

III.1.5. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, si edhe nga përllogaritjet e kryera, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se oferta ekonomike në vlerën prej 12,290,715.04 lekë pa TVSh , në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton anomalisht e ulët. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomik për ofertën anomalisht të ulët duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të lex specialis.

Në interpretim literal të nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët. Gjithashtu, KPP gjykon, se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për t’i dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik do të përmbushë me sukses kontratën. Së pari, operatori ekonomik ankimes duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve, ose për kryerjen e punës. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët, të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi. Ata duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, në vendin ku do të

kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi si edhe së fundmi të argumentojnë apo provojnë mundësinë e tyre për të përfituar ndihmë shtetërore. Referuar nenit 93 pika 3 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. **KPP gjykon, se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. KPP gjykon, se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime, ndër të tjera si: rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kostot që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, KPP thekson, se referuar nenit 2 gërma “b” “Qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se; “Qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale”.** Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës, që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj. Sa më sipër, referuar rastit në fjalë dhe themelit të kërkimit të operatorit ekonomik ankimues, KPP gjykon vetëm mbi dokumentet e dorëzuara pranë autoritetit kontraktor dhe në rast se këto të fundit përmbushin në mënyrë të detyrueshme katër kushtet e para kumulative të parashikuara nga neni 93 pika 2 i LPP-së, si dhe mundësinë për të përmbushur kushtin e pestë, mospërmbushja e të cilit nuk përbën shkak për dështimin e operatorit ekonomik në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

III.1.6. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “*Infosoft Office*” SHPK, në mbështetje të ofertës anomalisht të ulët të paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, rezulton, se ky i fundit është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Konkretisht, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik “*Infosoft Office*” SHPK, ka paraqitur si dokumentacion mbështetës ose provues: argumentimin e ofertës në mënyrë narrative përmes shkresës datë 19.01.2022 me lëndë “*Sqarim për ofertën anomalisht të ulët*”, ku ka shpjeguar të gjitha elementet e ofertës së paraqitur prej tij dhe duke e justifikuar çmimin e ofertuar bazuar në disa komponentë. Konkretisht ankimuesi ka deklaruar se: *duke qenë tenderi më i rëndësishëm në vend me synimin për ta fituar kemi ofertuar me një normë fitimi të ulët gjë që shpjegon edhe vlerën e ulët të ofertës. Ky tender ka edhe një specifikë tjetër pasi për herë të parë në historinë e zhvillimit të kësaj procedure është lejuar edhe ofertimi me tonera ekuivalentë. Ofertimi pjesërisht me tonera ekuivalentë të cilët janë më ekonomik në çmim sesa origjinalet sjell edhe këtë vlerë të ulët dhe diferencë nga fondi limit. Për t’ju sqaruar lidhur me anën ekonomike të kësaj oferte po ju paraqesim një analizë të detajuar të kostos me përlllogaritje për çdo artikull dhe me të gjithë elementët përbërës të çmimeve mbështetur në fatura blerje artikujsh, fletë zhdoganimi, oferta të marra nga furnitorët tanë. Sqarojmë se për një pjesë të tonerave lexmark dhe Xerox origjinalë oferta është marrë nga distributori rajonal*

përkatësisht Infolex dhe Xerox ndërsa furnizimi me produkte do të realizohet përmes distributorit vendas ITD ShPK. Përveç kësaj, KPP vëren, se ankimuesi në mbështetje të deklarimeve më sipër, ka paraqitur Analizë kosto loti 1 për të gjithë artikujt objekt-prokurimi (emërtimi, lloji i pajisjes, kodi, ngjyrat , njësia, sasia, çmimi i ofertuar/njësi pa TVSh, çmimi i blerjes /njësi pa TVSh, me sqarimin se për një pjesë të tonerave Lexmark dhe Xerox origjinale oferta është marrë nga distributori rajonal përkatësisht infolex dhe xerox ndërsa furnizimi me produkte do të realizohet përmes distributorit vendas ITD ShPK.

<i>Shpenzime të përgjithshme</i>	
<i>Paga punonjësish</i>	10 %
<i>Kosto transporti nga importi</i>	10 %
<i>Kosto transporti për lëvrimin</i>	1.8 %
<i>Kosto të tjera (dogana, qira, energji elektrike, noterizime etj.</i>	2 %
<i>Fitimi</i>	20.9 %

Gjithashtu ankimuesi ka paraqitur Analizë Kosto të Përgjithshme për të gjitha lotet., Fatura Tatimore Shitje, Deklarata Doganore, Ofertë nga Albamedia, Ofertë nga i.Aicon Zhuhai Aicon Image co ltd, Ofertë nga Lexmark, Ofertë nga Union Technology International, Vërtetime Realizimi Kontratash, Deklaratë Zhuhai Aicon Image co ltd, Deklaratë Union Technology International, Certifikata ISO, Vërtetim numër punonjësish.

KPP gjykon, se ankimuesi në rastin konkret ka arritur nëpërmjet dokumentacionit provues sa më sipër të argumentojë në mënyrë bindëse të gjithë elementët e ofertës së tij. Përveç argumentimit në formën e një narrative ku shpjegon çmimin e ofertuar prej tij dhe elementet favorizuese që disponon, të tilla si eksperiencia e gjatë në treg, realizmi i një sërë kontratash me subjekte të ndryshme, lidhjet me prodhuesit dhe mundësisë së ofertimit edhe me tonera ekuivalentë, duke i provuar të gjitha deklaratimet e tij me dokumentacion justifikues, si fatura tatimore, deklarata doganore, oferta dhe deklaratë nga prodhuesit dhe distributorët e autorizuar, ankimuesi ka paraqitur edhe analizën e detajuar të koston në përmbushje të germës a) të nenit 93 të LPP, ku flitet për anën ekonomike të **metodës së ndërtimit dhe paraqitjes së analizës së koston për të gjitha elementet**. Operatori ekonomik ankimues ka detajuar analizën e koston në trajtë analitike, duke e argumentuar me prova dhe fakte dhe ka justifikuar çmimin e ofertuar për çdo zë (përfshirë çmimin e blerjes, paga punonjësish, kosto transporti nga importi, kosto transporti për lëvrimin), Kosto të tjera (dogana, qira, energji elektrike, noterizime etj, dhe fitimin e kompanisë në përqindje). Në këtë kuptim, KPP gjykon se ankimuesi ka përmbushur të gjitha kushtet kumulative të parashikuara nga neni 93 i LPP-së.

Lidhur me argumentet e dhëna nga KSHA në kthim-përgjigjen drejtuar ankimuesit se “*Pra sipas shkresës sqaruese të dërguar nga ofertuesi, ky i fundit pranon se fitimi neto në përqindje për këtë procedurë prokurimi është 20.9 % duke rënë ndesh me argumentet e dorëzuara në fillim prej tij, KPP gjykon, se gjykimi mbi analizën e koston së paraqitur bëhet në tërësi dhe jo mbi një element të veçantë të tij sikundër në rastin konkret fitimi i kompanisë. KPP gjykon, se vetëm ky element i analizuar nga KSHA nuk mund të përbëjë shkak për skualifikim, pasi nuk është një element esencial që ndikon në zbatimin e kontratës për të cilin*

autoriteti kontraktor duhet të jetë i interesuar. Anomalitë në përqindje të lidhura me fitimin e kompanisë, nuk janë një arsye e qenësishme, pasi elemente të tjera të cilat lidhen me çmimin e shitjes dhe të blerjes të cilat ankimesi i ka dokumentuar dhe provuar me dokumentacion konkret, në këtë rast e bëjnë ofertën e tij të pranueshme dhe të justifikuar sa i përket elementit anomalisht të ulët në përputhje me nenin 93 të LPP-së. Akoma më tej, vetë autoriteti kontraktor në informacionin mbi procedurën të paraqitur pranë KPP pranon, se diferenca midis çmimit të ofertuar dhe vlerës totale të çmimit të blerjes për këto artikuj është 3.492.886 lekë pa TVSh, pra çmimi i blerjes së artikujve është dukshëm më i ulët se çmimi total i ofertës së dhënë.

Gjykata Europiane e Drejtësisë (Luksemburg) është shprehur se “*Cilido qoftë legjislacioni, autoritetet kontraktore janë të detyruara të identifikojnë dhe hetojnë Ofertat Anomalisht të Ulëta, pavarësisht nëse ata kanë për qëllim t’i s’kualifikojnë ato*”. Kjo qasje mbështetet nga fakti se, Komisioni Europian, ndërsa draftonte Direktivën përkatëse, kishte përpara tij Opinionin e Komitetit Ekonomik e Social të Këshillit Europian (CES 515/2001), i cili propozonte se: “*Në rast të një oferte anomalisht të ulët ... duhet të specifikohet se autoritetet kontraktore duhet t’i hetojnë ofertat të cilat duken se janë anomalisht të ulëta. Duhet të përcaktohet qartësisht se ofertat në fjalë do të refuzohen nëse nuk do të paraqitet një justifikim i përshtatshëm*”. Ky parashikim është parë nga këndvështrimi i mbrojtjes së autoriteteve kontraktore, nga ofertues që do të fitonin kontrata përmes çmimesh të pambështetura, me rrezik potencial për të rinegociuar fondin limit pak kohë pas lidhjes së kontratës; keqpagimin e punëtorisë apo të nënkontraktorëve, apo përdorimin e materialeve të cilësisë së ulët. Komisioni Europian ka deklaruar, se ky është një problem i hasur posaçërisht në industrinë e ndërtimit. Një ofertë anomalisht e ulët mund të justifikohet ekonomikisht përmes metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushteve përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar. Në rastin konkret vetëm elementi i fitimit të kompanisë dhe asnjë anomali tjetër në paraqitjen e detajuar të analizës së kostos nuk shkakton asnjë nga rreziqet potenciale të sipërcituara. Fitimi i kompanisë është një element që lidhet me politikën e kompanisë, por nuk prek në asnjë moment autoritetin kontraktor me ndonjë rrezik të mundshëm të mosrealizimit të kontratës, i cili është dhe duhet të jetë qëllimi primar i autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e operatorit ekonomik ankimesi janë dorëzuar të gjitha dokumentet provuese mbi metodën e ndërtimit të ofertës ekonomike mbi të cilën edhe operatori ekonomik ka ofertuar në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues, origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi; pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, duke argumentuar plotësisht, se pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës. Argumentimi i dhënë nga ofertuesi në rastin konkret, krijon bindjen, se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimesi “*Infosoft Office*” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e*

rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*Infosoft Office*” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF-00443-07-07-2021, me objekt “*Blerje Tonera*” e ndarë në 8 (tetë) lote”, me Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 259,114,090 (dyqind e pesëdhjetë e nëntë milionë e njëqind e katërbëdhjetë mijë e nëntëdhjetë) Lekë pa TVSH ose 2,113,147 € (dy milionë e njëqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e dyzetë e shtatë) Euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë i datës 01.07.2021 është 122.62 Lekë, Loti 1 “*Blerje Tonera për Ministrinë e Mbrojtjes dhe institucionet e vartësisë*”, me Nr. REF-00446-07-07-2021 me fond limit 34.988.077 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.11.2021 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “*Infosoft Office*” SHPK, si dhe të korrigjojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Infosoft Office*” SHPK.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri